

**20 Tetor**

## **Dita Botërore e Osteoporozës**

Dita Botërore e Osteoporozës është organizuar për herë të parë në 20 tetor të vitit 1996 nga Shoqata Kombëtare e Osteoporozës në Mbretërinë e Bashkuar, me mbështetjen e Komisionit European.

Prej vitit 1997, Dita Botërore e Osteoporozës organizohet çdo vit në 20 tetor, dhe udhëhiqet nga Federata Ndërkombëtare e Osteoporozës.

Dita Botërore e Osteoporozës është një fushatë sensibilizuese mbarëbotërore, e cila ka si qëllim të rrisë informimin dhe ndërgjegjësimin për parandalimin, diagnozën e hershme dhe trajtimin e osteoporozës.

Që nga fillimi i saj, Dita Botërore e Osteoporozës ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes publike për shëndetin e kockave, për parandalimin e osteoporozës dhe thyerjeve të kockave prej saj. Fushatat vjetore kanë qenë gjithashtu të suksesshme në rritjen e ndërgjegjësimin publik edhe për çështje të tjera specifike si: osteoporoza te meshkujt, osteoporoza mbas menopauzës, ushqimi për kocka të shëndetshme, ndikimi i frakturave në cilësinë e jetës, roli i aktivitetit fizik në shëndetin e kockave, thyerjet vertebrore, faktorët e rrezikut, parandalimi i thyerjeve sekondare etj.

Dita Botërore e Osteoporozës çdo vit ka patur tema dhe mesazhe specifike

*Për më tepër shiko “Osteoporoza” në: <http://www.ishp.gov.al/shendeti-riprodhues/>*